



# REVISTË VJETORE

Federata e Familjes – Shqiperi  
2020

## Përmbajtja

### 3 Fjale nga Nëna e Vërtetë

Lorem ipsum dolor sit amet, consectetur adipiscing elit. Praesent scelerisque mi lacus, vel suscipit nisi ultricies sagittis. Suspendisse viverra lorem vitae felis egestas, vitae vestibulum odio viverra lorem vitae felis egestas volutpat.

### 4 1 vit Shqipëri Qiellore

Nulla vel ligula a ex rutrum placerat et et lectus. Etiam et elementum eros, ut volutpat nisi. Ut vitae felis felis. Integer fermentum tortor sed metus lacinia ultrices. Praesent a porta velit. Curabitur ligula libero, dictum in venenatis sed, tincidunt eget mi.

### 6 Providenca e ÇonBo-së

In hendrerit congue suscipit. Suspendisse euismod diam efficitur ex commodo, eu rutrum nisi ullamcorper. Etiam placerat enim enim, non cursus purus tempor vel. Fusce ac porttitor dolor.

### 8 Ndryshimi i lidërshiptit në nivel kombëtar

Donec vitae dictum ex, eu dictum purus. Vivamus sed libero et ligula hendrerit eleifend. Vestibulum blandit dictum leo non sodales. Cras dignissim eleifend risus vel consectetur.

### 10 Ndryshimi i lidërshiptit në Durrës, Elbasan, Shkodër, Tirana 1

Ut sollicitudin id neque at tempor. Sed sit amet varius neque, eget semper purus. Aenean faucibus, quam in mattis malesuada, augue nisl malesuada enim, at porttitor tellus dui quis sem. Proin consectetur arcu leo, a semper mi dignissim eget. Nam feugiat leo quis faucibus volutpat.

### 13 Komuniteti i Diasporës së Shqipërisë Qiellore

Etiam sed est scelerisque, faucibus nisl eu, sodales purus. Aliquam a magna vitae nisi feugiat volutpat. Proin vitae vestibulum lorem.

### 14 Komuniteti i Shenjtë i Prindit Qiellor

Integer at molestie eros. Etiam sem metus, cursus volutpat rutrum vel, elementum malesuada libero. Ut luctus eros erat. Aenean rutrum convallis tellus vitae condimentum.

## Përmbajtja

### 15 Përvjetori i 8 i ngjitjes së Babait të Vërtetë

Lorem ipsum dolor sit amet, consectetur adipiscing elit. Praesent scelerisque mi lacus, vel suscipit nisi ultricies sagittis. Suspendisse viverra lorem vitae felis egestas, vitae vestibulum odio viverra lorem vitae felis egestas volutpat.

### 17 Përrurimi i librit me kujtime të Nënës së Vërtetë, “Nëna e Paqes”

Nulla vel ligula a ex rutrum placerat et et lectus. Etiam et elementum eros, ut volutpat nisi. Ut vitae felis felis. Integer fermentum tortor sed metus lacinia ultrices. Praesent a porta velit. Curabitur ligula libero, dictum in venenatis sed, tincidunt eget mi.

### 19 15 vjetori i Federates se Paqes Universale dhe Asambleja

In hendrerit congue suscipit. Suspendisse euismod diam efficitur ex commodo, eu rutrum nisi ullamcorper. Etiam placerat enim enim, non cursus purus tempor vel. Fusce ac porttitor dolor.

### 22 Përmbledhje nga eventet të spikatura nga Qendrat

Donec vitae dictum ex, eu dictum purus. Vivamus sed libero et ligula hendrerit eleifend. Vestibulum blandit dictum leo non sodales. Cras dignissim eleifend risus vel consectetur.

### 33 Plane dhe evente të parashikuara në 2021

Ut sollicitudin id neque at tempor. Sed sit amet varius neque, eget semper purus. Aenean faucibus, quam in mattis malesuada, augue nisl malesuada enim, at porttitor tellus dui quis sem. Proin consectetur arcu leo, a semper mi dignissim eget. Nam feugiat leo quis faucibus volutpat.

### 34 Përshëndetja e Presidentes

Etiam sed est scelerisque, faucibus nisl eu, sodales purus. Aliquam a magna vitae nisi feugiat volutpat. Proin vitae vestibulum lorem.

### 36

Integer at molestie eros. Etiam sem metus, cursus volutpat rutrum vel, elementum malesuada libero. Ut luctus eros erat. Aenean rutrum convallis tellus vitae condimentum.

## Festimi i Fitores i Tubimit për një Marshim Shpresëdhënës për një Shqipëri Qiellore



Unë shoh shpresë për Evropën. [Brohoritje dhe duartrokitje] Megjithëse disa aspekte të aktivitetit mund të kenë mungësi në sytë e Qiellit, rinia jonë e brezit të parë dhe të dytë janë udhëheqësit e së ardhmes. Është kaq bukur të shohësh që ata po rriten të shëndetshëm. Jam shume e lumtur. [Duartrokitje] Në të vërtetë, sa i përket providencës, Evropa mund të quhet kontinenti i parë. Mirëpo, duke parë realitetin e sotëm, ne nuk mund të themi se ajot është e para. Kjo më kujton një varg në Bibël, Mateu 7: 7. Kërkoni! Nëse kërkoni, çfarë do të ndodhë? Do t'ju jepet. Kërkoni! Dhe do të gjeni. Trokitni! Dhe dera do t'ju hapet. Ky është vargu i duhur biblik për Evropën sot. A nuk mendoni kështu?

Unë i kam riorganizuar të gjitha ish-rajonet e Afrikës

dhe Azisë, plus Korenë dhe Japoninë, në pesë nën-rajone, dhe e kam ndarë Evropën në gjashtë nën-rajone. Sidoqoftë, vendi me aktivitetet më të pakta nën-rajonale është Evropa. A jeni dakord? A nuk patët guxim? Apo besim? Çfarë mungonte? Siç thuhet në Bibël, ju duhet të kërkoni, të kërkoni dhe trokitni. A mund ta bëni këtë? [Po.] Unë po flas fort sepse nuk besoj se mund të arrijmë rezultate të mira me sistemin aktual. Arsyeja që erdha në Shqipëri ishte që të zgjoja Evropën edhe më tej. Në fakt, për shkak të shëndetit tim, unë nuk isha në gjendjen për të ardhur këtu. Shumë nga drejtuesit thanë se shpresonin që unë ta anulova aktivitetin në Shqipëri, sepse programi i udhëtimit nëpër botë deri në vitin 2020 është shumë i ngjeshur. Ata thanë: “Nënë, në moshën tënde nuk këshillohet të qëndroni në aeroplan për kaq shumë orë”. Kjo është ajo që thanë. Dider [Shmid] gjithashtu tha: “Nënë, shpresoj që të jetosh në këtë tokë për kohë të gjatë!” Për ta bërë këtë, a duhet të kujdesem për

shëndetin tim apo jo? [Po, të lutem, bëje!] Sidoqoftë, unë dëshiroja t'i jepja një shans tjetër Evropës, kështu që mbledha guximin tim dhe erdha. [Duartrokitje.]

Nga ana gjeografike Gadishulli Ballkanik është një gadishull i bukur. Mirëpo, kur shohim historinë, në veçanti historinë evropiane, ajo ka qenë shumë e tmerrshme. Luftërat këtu kanë qenë kaq brutale dhe të tmerrshme, gjatë tridhjetë viteve, që pas Luftës së Parë Botërore dhe deri kur mbaroi Lufta e Dytë Botërore. Prandaj, OKB u formua për të gjetur një rrugë drejt paqes botërore, pa luftëra të tjera në Evropë, natyrisht, por edhe në të gjitha kombet e botës.

Vitin tjetër do të bëhen 75 vjet nga inaugurimi i OKB-së. Sidoqoftë, çfarë ka arritur OKB? Shtetet anëtare të OKB-së kanë vendosur interesat e tyre të parat. Ato nuk lëshojnë pe. Ato nuk mund të bashkohen. E njëjta gjë është e vërtetë edhe me BE-në. Kjo është arsyeja pse ju thashë dje se organizatat dhe grupet e krijuara nga njerëzit nuk mund të zgjatin shumë. Kur shikojmë situatën e botës sot, udhëheqësit e saj do të ndiejnë se ka një kufi në atë që njerëzit mund të bëjnë. Megjithatë, udhëheqësit me shumë babëzi do të përpiqen ta shtyjnë atë deri në fund. Sidoqoftë, Zoti është gjallë. Për shkak se Zoti ekziston, nuk do të ketë më diktatorë në të ardhmen ashtu si [kishte në të kaluarën. E kuptoni? [Po.] Atëherë, çfarë duhet të bëni? Për të realizuar një botë paqeje njerëzit duhet të ndryshojnë. Pavarësisht gradës ose pozitës, ju duhet të ndryshoni. Kjo është arsyeja pse Vajza e Vetme e Lindur prej Zotit, Nëna e Vërtetë, është shfaqur për herë të parë në 6,000 vjet. Që Prindërit e Vërtetë ta kthejnë botën në pozitën nga ku ajo nuk ka asnjë lidhje me Satanin ose mëkatin, dhe që ta kthejnë botën në gjendjen që ishte në kohën e krijimit të saj. [Duartrokitje.]



## 1 vit Shqipëri Qiellore

Mbi 400 pjesëmarrës nga 50 vende morën pjesë në Samitin e Paqes për Evropën Juglindore, të organizuar nga Federata e Paqes Universale në Tiranë, Shqipëri. Takimi i nivelit të lartë u mbajt nga data 25 deri më 27 tetor 2019. Seancën plenare të hapjes së Samitit e nderuan me praninë e tyre themeluesja e Federatës së Paqes Universale Dr. Hak Ja Han Moon; presidenti i Maqedonisë së Veriut, Sh.T. Stevo Pendarovski; presidenti i Kosovës, H.E. Hashim Thaçi; dhjetë ish-kryetarë shtetesh dhe qeverish dhe figura kryesore politike nga rajoni i Ballkanit. Më shumë se 70 parlamentarë dhe ministra të qeverive aktuale dhe të mëparshëm morën pjesë në seancat e Samitit. Me dhjetëra udhëheqës fetarë nga Evropa, Lindja e Mesme dhe Afrika ishin pjesë e Samitit. Komuniteti fetar shqiptar



u përfaqësua nga z. Bujar Spahiu, kryetar i Komunitetit Mysliman; Baba Edmond Brahimaj, Kryegjyshi Botëror i Bektashinjve; znj. Nikki Doçi, përfaqësuese e Aleancës Ungjillore Shqiptare; si dhe Dr. Genti Kruja, sekretari i përgjithshëm i Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë. Pesëmbëdhjetë organizata dhe institucione të rëndësishme ishin partnerë zyrtarë të samitit, si Bashkia e Tiranës, Klubi i Podgoricës i ish-kryetarëve të shteteve dhe qeverive të rajonit të Ballkanit, Këshilli i Paqes i Ukrainës, Urdhri Botëror Bektashi, Universiteti i Tiranës dhe organizata të tjera nga bota akademike dhe ajo e biznesit. Organizatat partnere të FPU-së përfshinin Fondacionin “Washington Times”, Federatën e Grave për Paqen Botërore (WFWP) dhe Akademinë Botërore Profesorëve për Paqe. Samiti i Paqes u zhvillua nën patronazhin e Kryeministrit të Shqipërisë. Komiteti organizues i samitit u bashkëkryesua nga Dr. Katsumi Otsuka, kryetari i FPU për Evropën dhe Lindjen e Mesme; Sh.T. Alfred Moisiu, President i Shqipërisë

(2002-2007); dhe Haxhi Dede Edmond Brahimaj, Kryegjyshi Botëror i Bektashinjve.

Samiti i Paqes ishte një mbledhje e rëndësishme për udhëheqësit në Ballkan. Konfliktet politike në rajon janë të forta, qoftë brenda shteteve apo edhe ndërmjet shteteve, si rasti i Kosovës dhe Serbisë.

Seanca e hapjes filloi me një seri fjalimesh mbi temën “Perspektivat për Paqen në Ballkan”, që u moderua nga Nënkryetarja e Kuvendit të Shqipërisë Prof. Dr. Vasilika Hysi. Fjala e parë u mbajt nga z. Talat Xhaferi, Kryetar i Asamblesë Kombëtare të Maqedonisë së Veriut, pasuar nga z. Albin Kurti, ish kryeministri i Kosovës dhe nga Ambasadori Christopher Hill, i cili ka shërbyer si ambasador i SHBA në Ballkan. Lançimi i Këshillit të Lartë Ndërkombëtar për Paqen (ISCP), një iniciativë e FPU, filloi me një mesazh përshëndetës nga znj. Elisa Spiropali, ministrja shqiptare e Marrëdhënieve me Parlamentin e cila foli në emër të qeverisë shqiptare, nën patronazhin e të cilës u mbajt samiti. Ajo u pasua nga Sh.T. Stevo Pendarovski, presidenti i Maqedonisë së Veriut dhe nga Sh.T. Hashim Thaçi, presidenti i Kosovës. Më pas, Presidenti Alfred Moisiu dha një mesazh si bashkëkryetar i samitit, përpara se të prezantonte bashkëthemeluesen e Federatës së



Paqes Universale, Dr. Hak Xha Han Mun.

Dr. Mun në fjalën e saj theksoi se megjithëse Shqipëria konsiderohej e fundit në Evropë, pas një historie të gjatë vuajtjesh, kishte ardhur koha që e fundit të bëhej e para.

Tetë ish-kryetarë shtetesh nga kombet që kishin qenë në konflikt gjatë luftërave Ballkanike u ngjitën në skenë për të marrë një medalje themeluese të Këshillit të Lartë Ndërkombëtar për Paqe nga Dr. Mun: Presidenti Stjepan Mesić i Kroacisë (2000-2010); Kryeministri Hasan Muratović i Bosnjë-Hercegovinës (1992-1995); Presidenti Fatmir Sejdiu i Republikës së Kosovës (2006-2010); Kryeministri Mirko Cvetković i Republikës së Serbisë (2008-2012);

Presidenti Zhivko Budimir i Republikës së Bosnjë-Hercegovinës (2011-2015); Ushtruesi i detyrës së presidentit Jakup Krasniqi i Republikës së Kosovës (2010-2011); Kryeministri Vilson Ahmeti i Republikës së Shqipërisë (1991-1992); dhe Kryeministri Bajram Kosumi i Republikës së Kosovës (2005-2006). Dr. Mun i kërkoi Presidentit Alfred Moisiu të drejtojë Këshillin e Lartë Ndërkombëtar për Paqen për rajonin e Ballkanit. Pasditen e datës 26 dhe paraditen e datës 27 tetor, u zhvilluan dhjetë sesione të Samitit në mjediset e Tirana International Hotel, ku morën pjesë rreth 400 personalitete nga 50 vende të botës. Një banket për 150 gra udhëheqëse për u organizua në mbrëmjen e 26 tetorit nga Federata e Grave për Paqe Botërore.



Në seancën e mbylljes së samitit, një audiencë prej afro 400 personash u bë pjesë e reflektiveve mbi “Perspektivat e Paqes në Evropën Juglindore” nga tre folës të shquar: Ministri austriak i Mbrojtjes Dr. Werner Fasslabend (1990-2000), Sh.T. Presidenti Bujar Nishani i Shqipërisë (2012-2017) dhe Dr. Michael Balcomb, kryetari i Federatës së Familjes për Paqe Botërore dhe Bashkimin (FFWPU) për Evropën dhe Lindjen e Mesme.



Një tjetër ngjarje kulmore e samitit ishte Festivali i Bekimit të Familjes ku morën pjesë përfaqësues nga të gjitha qytetet e Shqipërisë dhe 61 Këshillat e Paqes të krijuara dy vitet e fundit në të gjitha bashkitë e vendit. Pjesë e festivalit ishin 1.200 çifte të cilët u bënë pjesë e ceremonisë së ripërkushtimit në martesë, që u drejtua nga Dr. Hak Xha Han Mun dhe që u transmetua live nga mediet. Afirmimi i rëndësisë së familjes si gur themeli i një shoqërie paqësore dhe të qëndrueshme, është në themel të vizionit dhe aktiviteteve të FPU-së. Dr. Mun u foli përsëri të pranishmëve për rëndësinë e forcimit të shoqërisë duke promovuar vlerat e familjes së vërtetë dhe dashurinë për kombin.

## Providenca e ÇonBo-së

Përveçse shumë domethënës për providencën botërore të Prindit Qiellor, ky vit ka qënë i mbushur me deklarime dhe arritje për Prindërit e Vërtetë, e një nga momentet më të veçanta ka qënë deklarimi i Çifteve ÇonBo. Nëna e Vërtetë ftoi të gjitha çiftet që përmbushnin kriteret e një niveli të tillë që të aplikonin për të marrë një bekim të tillë. Personat që mund të aplikonin duhet të kishin arritur restaurimin e 430 brezave vertikalisht, duke çliruar e bekuar paraardhësit e tyre, dhe horizontalisht, duke realizuar misionin e Mesisë Fisnore me 430 çifte të bekuara.

Nderin e titullit “Çift ÇonBo” nga Shqipëria Qiellore e morën 6 çifte, të cilat u deklaruan në Festivalin e ÇonBo më datë 10 tetor, janë çifti Vasmatics, Rroshi, Ziko, Matraku dhe pavarësisht distancës, edhe Rev. Shin dhe GugJin Shin. Deklarimi i tyre dhe ky bekim i dhënë nga Prindërit e Vërtetë me anë të titullit “Çift ÇonBo” ishte pjesë e disa ceremonive, të cilat pavarësisht që bëheshin nëpërmjet ekranit në lidhje të drejtpërdrejtë me Qendrën Botërore të Paqes, ishin po aq prekëse sikur të ishim aty. Gjithashtu, Festivali i madh i ÇonBo-së për të festuar 100 Vjetorin e Lindjes së Babait të Vërtetë dhe 60 Vjetorin e Martesës së Shenjtë të Prindërve të Vërtetë ishte i mbushur me performanca prekëse dhe mesazhe e fjalime që prekën zemrat e mijëra pjesëmarrësve online nga e gjithë bota.

Anëtarët shqiptarë të pranishëm dhe pjesëmarrës nga e gjithë bota dëshmojnë në reflektimet e tyre hirësinë e madhe që morën, zemrat e tyre të mbushura me frymëzim dhe vendosmëri të re për ta çuar përpara providencën drejt vitit 2027. Mesazhi i Nënës së Vërtetë ishte burim frymëzimi dhe dashurie për të gjithë, dhe ajo thekson sërish



shpresën që i gjithë Komuniteti i Shenjtë i Prindit Qiellor do të bëhet një shembull për të gjithë botën, që merr respekt dhe dashuri brez pas brezi, përgjatë historisë njerëzore. Më poshtë është fjalimi i plotë i Nënës së Vërtetë në këtë ditë të shënuar:

How long we have been waiting for this one day! Our Heavenly Parent has wanted to fulfill His dreams together with his children on earth. However, the human Fall filled our Heavenly Parent with so much pain. How difficult it has been for Him, how much He has endured, how long He has waited for this moment.

The families inducted as Cheonbo today are the authentic citizens of Cheon Il Guk, registered as the original clear and pure Cheonbo (heavenly treasures) that Heavenly Parent has dreamed of seeing.

While we are on earth we must offer to the Heavenly Parent, who has been waiting, one family of humankind that attends the Parent of all people, which is Heavenly Parent's and True Parents' heartfelt desire. In welcoming this day, families inducted into CheonBo today have the responsibilities of the citizens of Cheon Il Guk. How we expand our heavenly spiritual energy as CheonBo families toward our neighbors, tribes, nations and the world



while we are on earth will determine whether we fulfill our responsibilities as families happily registered under the name of CheonBo—and through this we will achieve eternal freedom when we go to the spirit world. I hope, then, that you will all become great and prominent families who receive respect and love forevermore, generation after generation, throughout the course of human history.

## Ndryshimi i lidershipit në nivel kombëtar

Të dielën më datë 23 shkurt, në Qendrën e Seminareve në Mullet u mbajt event i për ndërrimin e presidentit të Federatës së Familjes. Pas një pune të vyer për 17 vite si president i Federatës së Familjes, z. Gani Rroshi ia kalon stafetën e drejtimit znj. Manjola Vasmatics, e cila me vendosmëri, aspiron suksese të mëtejshme.

Z. Gani dhe znj. Marjeta shprehën mirënjohjen e tyre për këto 17 vite të mbushura me bekime. Paralelisht misionit ku rrisnin fëmijët shpirtërorë, ata krijuan familjen e tyre dhe i dhanë të gjithë kombit dashurinë e një prindi të vërtetë. Në ditë fitoreje apo vështirësie, në ditë suksesi dhe lodhjeje, ata nuk kanë hequr dorë e kanë dhënë



shembullin e një çifti të bashkuar me misionin për t'i sjellë gëzim zembrës së përvuajtur të Prindit Qiellor. Mes lotësh gëzimi dhe mirënjohjeje, ata lënë pas një themel të konsoliduar për kombin tonë, dhe e mbyllin misionin e tyre për të investuar nga pozita të tjera tani, e duke

hapur udhë zhvillimit të providencës nën lidershipin e ri.

Në event ishin të pranishëm rreth 120 anëtarë nga të 9 degët e Federatës në Shqipëri dhe Kosovë, ndër të cilët spikat prania e Dr. Michael dhe znj. Fumiko Balcomb, President Rajonal i Europës dhe Lindjes së Mesme, dhe Dr. Katsumi Otsuka, Kryetar i Federatës së Paqes Universale për Europën dhe Lindjen e Mesme.



## Ndryshimi i lidershipit në Durrës, Elbasan, Shkodër, Tirana 1

Ndër eventet e shënuara të këtij viti kanë qenë ndryshimet e lidershipit në disa prej Qendrave tona; në Durrës, Elbasan, Shkodër dhe Tiranë. Vëllezër dhe motra që kanë investuar prej vitesh për të mbështetur dhe rritur komunitetet e tyre, e kanë mbyllur misionin e tyre publik për të filluar kapituj të tjerë të jetës së tyre. Le t'i shohim me rradhë.

### Durrës

Më datë 27 korrik, mes mirënjohjesh dhe lotësh gëzimi, u mbajt event i ndërrimit të koordinimit të Qendrës në Durrës. Arjan dhe Eranda Haziraj, pas 7 vitesh investim të sinqertë me një zemër të pastër, ia pasuan drejtimin e Qendrës së Durrësit çiftit Marsida dhe Erson Baloshi. Arjani dhe Eranda morën përsipër misionin e liderit të qytetit të Durrësit në vitin 2013, vetëm 2 vite pasi ishte



themeluar Qendra e Durrësit. Mes vështirësive të fillimit, me vendosmëri për të ofruar suksese dhe fitore për Prindërit e Vërtetë, ata e çuan përpara providencën në Durrës duke rritur numrin e anëtarëve dhe nivelin e zembrës së tyre. Veçanërisht, fakti që një prej fëmijëve të tyre shpirtërorë i pason ata, mbush zembrën e tyre me shumë gëzim.



### Shkodër

Në ditën e parë të muajit gusht, në qytetin e Shkodrës u mbajt event i përmbylljes së investimit në Shkodër të koordinatores së degës atje, Dajana Doce, pas 3 vitesh pune të palodhur dhe investimi të sinqertë. Që në kohët



e para të misionit të Dajanës vite më parë, Shkodra ka qenë për të një vend i veçantë, e në vitin 2017 erdhi më pranë zemrës së saj. Ose më mirë të themi, Dajana e mori Shkodrën në qendër të zemrës së saj duke marrë përsipër misionin për të çuar përpara providencën në Shkodër. Këto 3 vite kanë qenë plot intensive në Shkodër dhe mes lotësh së një zemrë mirënjohëse, Dajana ia pason drejtimin e Shkodrës çiftit Arnold Grami dhe Senarda Demaj. Puna e Dajanës e ka çuar Shkodrën në nivele të larta, e së bashku me të, edhe zemrën e Dajanës, që mbetet gjithmonë plot dashuri për Shkodrën dhe anëtarët e Shkodrës.



### Tiranë

Qendra e radhës që pati ndryshim lidershipi ishte Tirana 1shi, ku eventit për këtë rast u mbajt më datë 23 gusht. Manjola dhe Gabor Vasmatics dedikuan veten e tyre për 7 vite rradhazi në Qendrën e Tiranës pa u ndalur, duke qenë pjesë aktive e jetës shpirtërore të komunitetit të Tiranës. Ata e mbyllin misionin si lider qendre për ta mbështetur providencën në pozitën si liderë kombëtarë, me vendosmëri akoma dhe më të madhe për ta

bërë Shqipërinë një komb Qiellor. Drejtimi i Qendrës së Tiranës i kalon Arlinda Elbasanit, tashmë pasi ajo ka kaluar disa vite në mbështetje të aktiviteteve në këtë Qendër. Manjola është dëshmuar në Tiranë dhe fakti që u rikthye para 7 vitesh për të investuar si lidere e Tiranës e bën të ndjejë që po i kthen mbrapsht qytetit që e “lindi”. Tani, duke u kujdesur për Tiranën dhe të gjitha Qendrat e tjera si lidere kombëtare, Manjola ndjen përgjegjësi akoma më të madhe për të sjellë suksese dhe fitore Prindit Qiellor, por njëkohësisht edhe vendosmëri më të madhe për të gëzuar zemrën e Prindërve të Vërtetë..

### Elbasan

Në Elbasan, mes mirënjohjesh dhe lotësh gëzimi, më datë 6 shtator u mbajt eventit i ndërrimit të koordinimit të degës së Federatës së Familjes në Elbasan. Ajet dhe Greta Bosi, pas 7 vitesh dedikim me një zemër të vendosur, e trashëguan drejtimin e Qendrës së Elbasanit çiftit Juljan Bradasheshi dhe Marjola Etsi. Misioni i Ajetit dhe Gretës gjithashtu filloi në vitin 2013. Ajeti ishte dëshmuar në Elbasan kur ishte student dhe ndjesia e tij për këtë qytet bazohej në një lidhje e fortë zemre. Të dy së bashku, duke mbështetur njëri-tjetrin dhe duke u kujdesur për anëtarët, zhvilluan shpirtin e Elbasanit dhe të zonës përreth, veçanërisht të fshatrave dhe qyteteve pranë Elbasanit me anë të Ceremonive të Bekimit. Pozita e tyre si prindër për anëtarët ka lënë shenja të forta në zemrën e tyre dhe ky qytet gjithmonë do të ketë një vend të veçantë në zemrën e Ajetit dhe Gretës.





Të gjithë personat më sipër janë heronj të Providencës që kanë një vend të veçantë në zemrën e Prindit Qiellor për shkak të vetë-mohimit të tyre për hir të të tjerëve. Ata janë shembuj në familjet e tyre, mes miqve të tyre dhe në komunitet ku jetojnë. Të gjithë ata janë tashmë mesi fisnore dhe kanë ndihmuar çifte të tjera të bëhen mesi fisnore, për të mos përmendur personat e panumërt që kanë ndihmuar që të njohin Prindërit e Vërtetë. E kjo gjë ka buruar nga zemra e tyre. Personat të thirrur nga Prindi Qiellor për të mbështetur Providencën e Tij, kanë cilësi unike që i bëjnë ata të posaçëm për atë mision specifik me të cilin Zoti i bekon. E ky bekim u është trashëguar pasuesve të tyre në secilën Qendër. Ata, me energji rinore dhe vendosmëri të re, duan ta zhvillojnë akoma më tej themelin që kanë gjetur dhe ta bekojnë akoma më shumë kombin tonë, për ta realizuar ëndrrën e Prindit Qiellor për Shqipërinë Qiellore.



Të gjitha këto evente u organizuan në atmosferë të lartë shpirtërore, ku mbizotëronte mirënjohja ndaj njëri-tjetrit dhe dashuria si në një familje. Por sidoqoftë, duke marrë parasysh pandeminë dhe rrezikun ndaj shëndetit, në çdo rast jemi përpjekur të mbajmë distancë fizike e të përdorim mjete të mbrojtjes vetjake.

## Komuniteti i Shenjtë i Prindit Qiellor


Pas përmbylljes me sukses të Samitit të Paqes 2020 në Seul në muajin shkurt, bota u gjuhëzua nga COVID-19. Karantina e muajve të parë futi në frikë gjithë njerëzimin. Duke parë se shpresa në mbarë botën po venitej, Nëna e Paqes, Dr. Hak Xha Han Mun, në muajin maj 2020 tha se njerëzimi më shumë se kurrë duhet të qëndrojë i bashkuar dhe kombet duhet të solidarizohen me njëri-tjetrin. Ajo deklaroi se tashmë i gjithë njerëzimi duhet të bëhet pjesë e Komunitetit të Shenjtë të Prindit Qiellor, sepse të gjithë janë pjesë e një familjeje njerëzore nën një Zot të vetëm. Në Shqipëri, ky event u mbajt më datë 21 qershor. U zhvillua online për shkak të kufizimeve por kishte \_\_\_ pjesëmarrës live dhe më shumë se \_\_\_ e kanë parë videon e eventit më pas.

Që pas Ngjitjes së Shenjtë të Babait të Vërtetë, Nëna e Vërtetë deklaroi Vizionin 2020 dhe duke punuar fort e duke ofruar dedikime të vazhdueshme, ajo arriti fitore të mëdha në nivele kombëtare dhe kontinentale. Pas këtyre sukseseve, eventet e 60 Vjetorit të Martesës së Shenjtë dhe të 100 Vjetorit të Lindjes së Babait të Vërtetë, iu ofruan Qiellit. Mbi këtë themel, Nëna e Vërtetë deklaroi Themelimin Përfundimtar të Çon Il Guk (Firm Establishment) gjatë 7 Vjetorit të Ditës së Themelimit, mbajtur në ditën e 13 të muajit të parë sipas Kalendarit Qiellor (6 shkurt 2020). Menjëherë pas kësaj, Nëna e Vërtetë ofroi dedikime të thella për 55 ditë dhe në ditën e 9 të muajit të 3 të Kalendarit Qiellor (1 prill 2020), në një takim të veçantë me liderët rajonalë të Federatës së Familjes dhe të Federatës së Paqes, Nëna e Vërtetë bëri këtë deklaram special:

“Duke qenë se unë ende jam në pozitën për të përfaquar të gjithë 7.7 miliard njerëzit në botë, emri ynë do të ndryshojë deri kur t’i kem përfaquar të gjithë, e do të jetë ‘Komuniteti i Shenjtë i Prindit Qiellor’”

Nëna e Vërtetë dha këtë mesazh bekimi që na çon në epokën e Themelimit Përfundimtar të Çon Il Guk, epokës së ndjekjes së drejtpërdrejtë të Prindit Qiellor. Dëshira e Zotit gjithmonë ka qenë që të bëhet Prindi i Vërtetë


vertikal i njerëzimit nën idealin e “Një familjeje nën Prindin Qiellor”. Me fjalë të tjera, Zoti ka pasur si qëllim që të jetë edhe “Nënë Qiellore”, jo vetëm “At Qiellor”, dhe që të rrisë individë qiellorë, fise qiellore, popuj qiellorë, kombe qiellore dhe një botë qiellore, ku individët, fiset, popujt, kombet dhe bota, ndjekin Zotin si Prind.



## Komuniteti i Diasporës së Shqipërisë Qiellore

Që në fillimet e Lëvizjes në Shqipëri, dëshmia ka qenë shumë aktive dhe vazhdimisht ka pasur anëtarë që janë njohur me Prindërit e Vërtetë, e që i janë bashkuar këtij udhëtimi qiellor. Një pjesë e mirë e tyre, ndër vite, janë larguar nga Shqipëria për shkakqe nga më të ndryshmet; disa kanë pasur partner të huaj dhe janë shpërngulur në kombin e tij apo të saj, disa kanë emigruar për një punë më të mirë, etj. Por diçka e përbashkët me të gjithë ata është që kanë mbajtur fort lidhjet e tyre me Shqipërinë. Për t'u qenë pranë, për të vlerësuar sërish punën e tyre dhe për t'i mbajtur të përditësuar me zhvillimet providenciale në komb, u krijua Diaspora e Shqipërisë Qiellore.

Drejtuar nga Marjeta Rroshi, ky "grupim" përbëhet nga të gjithë ata vëllezër dhe motra të dëshmuar në Shqipëri



e që jetojnë përtej kufijve kombëtarë. Mbi 50 persona janë pjesë e Diasporës së Shqipërisë Qiellore, të shpërndarë në të gjithë cepat e botës.

Pasi një kërkim intensiv për të gjetur kontakte me ta dhe pas disa përgatitjesh, më në fund u arrit që më datë 14 qershor 2020 të mbahej takimi i parë online i Diasporës. Ky takim ishte me plot emocione nga të gjithë të pranishmit, dhe aty-këtu edhe me lot nga malli dhe nga kujtimet e përzemërta që ata patën për kohën e para 15-20 viteve më parë. Në prezantimin e parë, doja të veçoja mirënjohjen e një prej vëllezërve nga Diaspora, i cili u shpreh kështu:

“Shqipëria më ka dhënë dy herë jetë: jetën fizike dhe jetën shpirtërore. Prandaj dhe mirënjohja që duhet të kem ndaj kombit tim duhet të jetë dyfishe.”

Ky takim i parë u pasua më tej nga takime të përmuajshme të Diasporës, në çdo të dielë të parë të muajit. Këto takime në Zoom na mbajnë pranë njëri-tjetrit dhe na lidhin akoma më shumë me njëri-tjetrin dhe kombin tonë. Në çdo takim përzgjidhen 2-3 persona, bazuar në kohën kur kanë marrë bekimin, dhe ndajnë rreth fillimit të jetës së tyre shpirtërore, ditët kur janë dëshmuar, kohët e misionit, bekimi dhe jeta e tyre. Sytë e tyre ngazëllesh kur rikujtojnë ato kohë të vjetra me mall dhe nostalgji. Vërtetë është për t'u vlerësuar sakrificat që ata kanë bërë në kohë të vështira, ku herë herë, edhe jeta e tyre ka qenë në rrezik. Por kur dëgjon dëshminë e tyre gjithë pasion, e kupton që Prindi Qiellor ka pasur vëmendje të veçantë për Shqipërinë dhe që investimi i tyre është përdorur më së miri në Shqipëri. Këto takime janë prekëse edhe për anëtarët e rinj, si në moshë shpirtërore edhe në moshë fizike, për shkak se shohin histori suksesi të këta vëllezër dhe motra, dhe shohin një grimcë të historisë së providencës në Shqipëri.



## Përvjetori i 8 i ngjitjes së Babait të Vërtetë

Për të festuar Përvjetorin e Ngjitjes së Babait të Vërtetë, u mbajt një event i veçantë më datë 12 shtator. Me rastin dhe të 100 vjetorit të lindjes së Babait të Vërtetë, ky event u titullua “100 Vite Përkushtim”, për të theksuar akoma më shumë jetën e Babait të Vërtetë përkushtuar realizimit të ëndrrës së Zotit. Tashmë u bënë 8 vite që kur Babai i Vërtetë, siç e përmend dhe në lutjen e tij të fundit, “përmbylli, përmbushi dhe arriti gjithçka” në jetën e tij në tokë. Tek të gjithë ne është ende i freskët kujtimi i atmosferës që ishte e pranishme kudo që ishte Babai i Vërtetë. Veçanërisht në persona që kanë qenë të pranishëm në evente ku Babai i Vërtetë ka qenë i pranishëm, nuk mungonte rikthimi i kujtimeve të këtyre rasteve kaq të veçanta, kujtime që do të trashëgohen brez pas brezi.



Salla u mbush me rreth 130 pjesëmarrës, duke ruajtur masat mbrojtëse të distancimit social, por në secilën prej zemrave në atë sallë ndihej një mirënjohje e thellë për Babain tonë të Vërtetë. Ambasadorët për Paqe patën rastin që me anë të fjalimeve të tyre të vlerësonin punën e madhe që Babai i Vërtetë çoi përpara për të sjellë një botë të paqes. Kjo ditë gjithashtu përkonte me 15 vjetorin e themelimit të Federatës së Paqes Universale, gjë që i solli Prindërit e Vërtetë në Shqipëri për herë të parë, pak pas themelimit. Mesazhet e anëtarëve ishin prekëse, duke na risjellë në mendje kujtime të përzemërta, kujtime të cilat u përforcuan akoma më shumë nga videot ku tregohej jeta, dedikimi dhe përkushtimi që Babai i Vërtetë shfaqti përgjatë gjithë jetës së tij.

Le të marrim një moment për ta ndjerë praninë e Babait tonë të Vërtetë, duke lexuar lutjen e tij të fundit:

\*\*\*ose Kurorën e Lavdisë këtu ne vend te lutjes\*\*\*

I have completed everything. Today, as I have returned the conclusion of the final perfection to You, Father, I know that up to this moment, I have offered my whole life to You. I am spending this time now to bring my life to its conclusion, to bring it to a close with utmost devotion, in accordance with Your will.

In order that we may return to the original Garden of Eden, the garden with no trace of the Fall, and surmount everything that came to be connected to Adam's portion of responsibility following the error committed by his betrothed, I, who have the authority to grant liberation and complete freedom to everything, declare that anyone who follows True Parents, be it someone in the fourth dimension, or be it someone who would otherwise go even to the fourteenth dimension of hell, will be adopted into the kingdom of heaven and registered in the fourth dimension.

I declare that if, centering on the fourteen sons and daughters, the tribal messiahs are able to fulfill the calling of national representatives and restore the 387 nations [of the Abel UN and Cain UN], everything will be brought to a conclusion. I have accomplished everything for this. I have completed everything. Aju!



## Përrurimi i librit me kujtime të Nënës së Vërtetë, “Nëna e Paqes”

Një nga eventet më të gëzueshme për këtë vit, ishte përrurimi i librit të kujtimeve të Nënës së Vërtetë. “NËNA E PAQES”, që fshin lotët e njerzimit titullohet ky libër që përmbledh rrugëtimin e jashtëzakonshëm të Nënës së Vërtetë nga momentet e para të jetës së saj në një vend të shkatërruar nga lufta, përpjekja për mbijetesë duke u larguar si refugjate, bashkimi me Babain e Vërtetë nën udhëheqjen e Zotit dhe rrugëtimin e tyre sëbashku si Prindër të Vërtetë për të sjellë shpresë dhe paqe në këtë botë.



Pas 2 muajsh përkushtim intensiv nga përkthyesi i librit z. Sokol Rexhepi, dhe mbi një muaj redaktim nga një skuadër e vendosur dhe e përkushtuar për t’ia dalë në kohë, ne mundëm që të mbajmë eventin e promovimit të librit “Nëna e Paqes” ditën e shtunë më datë 31 tetor, në ambientet e Hotel Tirana International, në sallën më të madhe, “Salla Akernia”, me kapacitet 400 persona, por në respekt të protokolleve të sigurisë për shkak të pandemisë së COVID-19, vetëm 130 persona mundën të marrin pjesë.

Muaji tetor është i rëndësishëm për organizatat tona sepse ishte tetori i vitit 2005 që Prindërit e Vërtetë erdhën për herë të parë të dy së bashkë në Shqipëri. Ishte 31 tetori i vitit 2011 që ne promovuam në gjuhën shqipe autobiografinë e Babait të Vërtetë dhe ishte në tetorin e vitit të kaluar që Nëna e Vërtetë ishte në Shqipëri dhe shpalli kombin tonë si Shqipëria Qiellore.

Pjesëmarrës në aktivitetin përrues ishin Anëtarët e Këshillit Drejtues të Federatës së Paqes Universale, anëtare të Federatës së Grave Shqiptare për Paqes, Koordinatorët e Federatës së Familjes, Familje të Bekuara dhe të

rinjtë nga CARP. Atmosfera ishte e mrekullueshme dhe programi i larmishëm bëri që koha të mos ndihej dhe të gjithë u bënë pjesë e emocioneve të singerta që përcollën referuesit dhe të rinjtë me performancat e tyre.



Pas një videoje prezantuese të përgatitur mbi librin, fjalën përshëndetëse në emër të Ambasadorëve për Paqe e mbajti Dr. Eva Çipi, Kryetare e Federatës së Paqes Universale. Më pas Dr. Saemira Pino, Kryetare e Komisionit të Akademikëve për Paqe pranë Federatës së Paqes dhe ish Ministre e Arsimit dhe Shëndetësisë, përcolli vlerësimet e saj të singerta për librin, duke qenë edhe një nga personat e përfshirë intensivisht në procesin e redaktimit.

Pas disa performancave të mrekullueshme nga fëmijët e vegjël nga Tirana dhe të rinjtë të CARP-it nga Elbasani, fjalën e radhës e mbajti z. Sokol Rexhepi i cili foli si përkthyes dhe si përfaqësues i skuadrës së botimit të librit. Mes të tjerash ai theksoi “Ndihej i privilegjuar që m’u dha mundësia për t’u shprehur sot mbi librin autobiografik ‘Nëna e Paqes’, jo vetëm si përkthyesi fillestar i kësaj shprehjeje të zemrës së Nënës së Vërtetë, por në radhë të parë si familje e bekuar dhe si anëtar i Federatës së Familjes në Shqipëri. Viti 2020 nuk ka qenë i lehtë, por gjithashtu nuk duhet të harrojmë se ky është edhe një vit jubilar në providencën e Zotit, duke shënuar 100 vjetorin e lindjes së Babait të Vërtetë, Reverendit Son Mjong Mun dhe njëkohësisht botimin e këtij libri me kujtime të Nënës së Paqes, dr. Hak Xha Han Mun”.

Përmes një video mesazhi, aktivitetin e përshëndeti edhe Presidenti i Federatës së familjes për Evropën dhe Lindjen e Mesme Dr. Michal Balkomb. Për të risjellë edhe një herë kujtimet e Samitit të Paqes rë vitit 2019 dhe vizitës së Nënës së Paqes në Shqipëri, u prezantua një video përmbledhëse e aktiviteteve të Samitit të Paqes.





Fjalën e mbylljes e mbajti zj. Manjola Vasmatics, Presidente e Federatës së Familjes në Shqipëri. Ndër të tjera znj. Manjola tha: “Ju ftoj të imagjinoni pak rrugën e jetës së Nënës së Vërtetë, e cila si një fëmijë refugjat i mbijetoi luftës, imagjinoni nje nene qe ka humbur jo nje, por 4 femije. Ajo nuk do te donte as te jetonte me. Imagjinoni nje grua qe ka humbur bashkeshortin,... nje grua qe eshte perballur me sfida te panumerta... Dhe per me teper, te mendosh qe ne nje moshe te tille, 77-vjec, nje gjyshe do te donte te shijonte nipat dhe mbesat e veta.

